

Nr. 11226/12 Prot.

Tiranë, më 04/02 2022

Lënda: **Kthim Përgjigje tuajës Nr.925/8 Prot, datë 15.12.2021 lidhur me plotësimin e informacionit mbi aplikimin për përcaktimin e tarifave të OSSH sha.**

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar
Enti Rregullator të Energjisë

Për Dijeni: **Zj.Belinda BALLUKU**
Ministër
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z.Adrian ÇELA
Administrator
OSHEE GROUP SH.A

I nderuar z. Ahmeti,

Në përgjigje të kërkesës suaj “Kërkesë për plotësim informacioni” me Nr.925/8 Prot. datë 15.12.2021 protokolluar në OSSH me prot. Nr.11226, datë 16.12.2021, shkresës së OSSH Nr. 10691/1, date 14.12.2021, sqarojmë se:

A. Si rrjedhojë e rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë në tregun e lirë llogaritjet në dokumentin e “Aplikimin për tarifa të shpërndarjes së energjisë për vitin 2022” sipas shkresës sonë Nr 8016/3 prot., datë 18.10.2021, do të duhet sërish të ndryshojnë. Nga përlllogaritjet e kryera me informacione të përditësuara rezultojnë se:

- a) Tarifa mesatare e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 duhet të jetë **6.69 Lekë/Kwh**
- b) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 35 kv duhet të jetë **2.62 Lekë/Kwh**
- c) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 20/10/6 kv duhet të jetë **4.14 Lekë/Kwh**

d) Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022 në tensionin 0.4 kv duhet të jetë **7.37 Lekë/Kwh**

- Ndryshimet në çmimin e blerjes së energjisë që do të përdoret për humbjet në rrjetin e shpërndarjes paraqiten në tabelën më poshtë:

			2021	Ishte 2022	Është 2022
Energji Gjithsej		Kwh	1,535,362	1,486,239	1,486,239
Sasi	Nga Ashta	Kwh	304,077	231,264	231,264
	Nga HEC private	Kwh	1,015,734	1,022,113	1,022,113
	Nga Burime të Rinovueshme	Kwh	42,425	43,274	43,274
	Nga Tregu i Lirë	Kwh	173,126	189,588	189,588
	Çmim				
Nga Ashta	Lekë/Kwh	7.75	8.57	8.10	
Nga HEC private	Lekë/Kwh	7.45	8.57	8.57	
Nga Burime të Rinovueshme	Lekë/Kwh	12.25	12.26	12.43	
Nga Tregu i Lirë	Lekë/Kwh	20.77	15.95	28.18	
Lekë	Nga Ashta	Lekë	2,356,740	1,980,822	1,873,238
	Nga HEC private	Lekë	7,565,190	8,754,600	8,754,600
	Nga Burime të Rinovueshme	Lekë	519,911	530,513	537,803
	Nga Tregu i Lirë	Lekë	3,596,113	3,024,060	5,342,588
	Kosto Totale		Lekë	14,037,954	14,289,996

Tarifa e transmetimit	Lekë/Këh	0.75	0.75	0.75
Shpenzime transmetimi	Lekë	701,522	664,679	664,679

Çmimi mesatar

9.1	9.6	11.1
------------	------------	-------------

- Ndryshimet në tarifën mesatare të shpërndarjes si rrjedhojë e ndryshimit të çmimit duke zbritur edhe të ardhurat e krijuara nga tarifa "0" kwh paraqiten në tabelën më poshtë:

Tarifa e Operatorit te Shpërndarjes 000/Lekë

Zëri	2021	2022
Kosto e humbjeve (sipas ERE)	14,037,954	16,500,965
Kosto e transmetimit për humbjet	701,522	664,679
Disbalanca	106,613	111,944

Shpenzime Operative	10,554,510	10,741,467
<i>Shpenzime materiale dhe konsumi</i>	295,800	304,674
<i>Shpenzime për personelin</i>	5,050,122	5,201,625
<i>Mirembajtje</i>	2,676,504	2,756,799
<i>Penalite dhe gjoba</i>		
<i>Shërbime Korporate</i>	1,259,831	1,167,947
<i>Maredhënie me Publikun dhe Marketing</i>	3,000	3,090
<i>Qera</i>	331,849	341,804
<i>Shërbime Postare dhe Komunikimi</i>	15,146	15,600
<i>Shpenzime Teknologjia e Informacionit</i>	10,000	10,300
<i>Shpenzime Ligjore</i>	1,000	1,030
<i>Konsulencë dhe Auditim</i>	50,000	51,500
<i>Të tjera</i>	861,259	887,097
Total OPEX	25,400,599	28,019,055
Vlera e asetëve në v. 2020	69,425,932	69,425,932
Vlera e investimeve që priten në v. 2021	7,146,537	14,293,073
Vlera e investimeve që priten në v. 2022		5,299,074
minus: Amortizimi i akumuluar	(25,446,937)	(29,818,289)
vlera e RAB pa përfshire kapitalin e punës	51,125,532	59,199,790
Kapitali i punës	2,116,717	2,568,255
RAB	53,242,248	61,768,044
Norma e interesit të borxhit të vjetër	2.41%	2.41%
Norma e interesit të borxhit të ri	0.88%	0.88%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	17.81%	17.81%
Borxhi i vjetër %	33.05%	33.05%
Borxh i ri %	26.95%	26.95%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjetër	0.80%	0.80%
Kthim për borxhin e ri	0.24%	0.24%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	7.12%	7.12%
WACC	8.16%	8.16%

Fitimi	4,344,248	5,039,902
Amortizimi i vitit	3,947,426	4,371,352
Të ardhura nga lidhjet e reja	(532,075)	(532,075)
Të ardhurat nga Mirembajtje "0" Kwh	(639,804)	(639,804)
Të ardhurat nga energjia reaktive	(371,226)	(420,560)
Korrigjim i të Ardhurave		2,806,355
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	32,149,168	38,644,225
Energji e shpërndare (MWH)	5,580,415	5,775,730
Tarifa mesatare e shpërndarjes Lekë/Kwh	5.76	6.69

Shënim:

Shpenzimet e Mirëmbajtjes sipas planit financiar të miratur për vitin 2021 përbëhen nga:

Mirëmbajtje	2,676,504
Shpenzime operative (materiale)	1,400,000
Riparime dhe mirëmbajtje e ndërtesave	25,000
Riparime dhe mirëmbajtje e makinave	192,439
Riparime dhe mirëmbajtje - te tjera	9,000
Riparim transformatoresh	300,000
Shpenzime Kolaudimi Matesash	750,064

Për vitin 2022 në aplikimin në tarifë janë detajuar vetëm shpenzime (materiale) të mirëmbajtjes së rrjetit për defekte si dhe ato të mirëmbajtjes së zakonshme që ndikojnë në performancë por jo në jetëgjatësinë e aseteve të cilat janë parashikuar **1,442 milionë Lekë (OPEX)** ndërsa vlera totale prej **2,095 milion Lekë** përfshin edhe shpenzimet kapitale të mirëmbajtjes së rrjetit (CAPEX).

Shpenzimet e Mirëmbajtjes për vitin 2022 janë parashikuar si më poshtë:

Mirëmbajtje	2,756,799
Shpenzime operative (materiale)	1,442,000
Riparime dhe mirëmbajtje e ndërtesave	25,750
Riparime dhe mirëmbajtje e makinave	198,212
Riparime dhe mirëmbajtje - te tjera	9,270
Riparim transformatoresh	309,000
Shpenzime Kolaudimi Matesash	772,566

Ndryshimet në tarifat e shpërndarjes sipas nivelit të tensionit në tabelën më poshtë:

Zëri	2022	Tension i Mesëm	Tension i Mesëm	Tension i Ulët
		35 kV	20-6 kV	0.4 kV
Shpenzime Operative	10,741,467	190,321	1,972,114	8,579,032
Kosto e transmetimit për humbjet	664,679	623	46,387	617,669
Kosto e humbjeve	16,500,965	15,469	1,151,571	15,333,926
Disbalanca	111,944	105	7,812	104,027
Total OPEX	28,019,055	206,518	3,177,884	24,634,654
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2020	69,425,932			
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2021	14,293,073			
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2022	5,299,074			
Vlera e asetëve Gjithsej	89,018,079	195,152	10,832,023	77,990,903
minus: Amortizimi i akumuluar	(29,818,289)	(65,370)	(3,628,391)	(26,124,528)
vlera e RAB pa përfshirë kapitalin e punës	59,199,790	129,782	7,203,632	51,866,375
Kapitali i punës	2,568,255	45,505	471,527	2,051,223
RAB	61,768,044	175,288	7,675,159	53,917,598
Norma e interesit të borxhit të vjetër	2.41%	2.41%	2.41%	2.41%
Norma e interesit të borxhit të ri	0.88%	0.88%	0.88%	0.88%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	17.81%	17.81%	17.81%	17.81%
Borxhi i vjetër %	33.05%	33.05%	33.05%	33.05%
Borxh i ri %	26.95%	26.95%	26.95%	26.95%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjetër	0.80%	0.80%	0.80%	0.80%
Kthim për borxhin e ri	0.24%	0.24%	0.24%	0.24%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	7.12%	7.12%	7.12%	7.12%
WACC	8.16%	8.16%	8.16%	8.16%
Fitimi	5,039,902	14,302	626,247	4,399,353
Amortizimi i vitit	4,371,352	9,583	531,921	3,829,848
Të ardhura nga lidhjet e reja	(532,075)	-	(107,115)	(424,959)
Të ardhurat nga Mirembajtje "0" Kwh	(639,804)	(8)	(4,264)	(635,532)
Të ardhurat nga energjia reaktive	(420,560)	(12,102)	(352,568)	(55,890)
Korrigjim i te Ardhurave	2,806,355	49,724	515,242	2,241,390
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	38,644,225	268,017	4,387,346	33,988,863
Energji e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes MWH	5,775,730	102,336	1,060,413	4,612,980
Tarifa mesatare e shpërndarjes Lekë/KWh	6.69	2.62	4.14	7.37

B. Ju lutem në vijim gjeni përgjigje lidhur me pyetjet tuaja si dhe dokumentacionin plotësues te kerkuar nga ana juaj.

1. Në materialin e përditësimit të aplikimit për shqyrtimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022, shoqëria OSSH sh.a duhet të argumentojë dhe dërgojë të dhëna lidhur me:

- Faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e komponenteve të të ardhurave të kërkuara duke evidentuar efektet e tyre në rritje;
- Rakordimin me përdoruesit e tjerë të rrjetit të shpërndarjes për sasinë e energjisë së parashikuar për t'u lëvruar gjatë vitit të ardhshëm duke vënë në dispozicion korespondencat përkatëse
- Përditësimi i parashikimeve tuaja për kërkesën për të ardhura mbështetur në dispozitat e VKM nr. 584, datë 08.10.2021 dhe VKM nr. 620, datë 22.10.2021.

Përgjigje:

- Faktorët e ndryshimeve janë pasqyruar në kërkesën për përditësim të Aplikimit për Tarifa të shpërndarjes në shkresën e dërguar me Nr.8016/1 Prot. datë 30.09.2021 dhe bazohen në:
 - a) Ka ndryshuar parashikimi për prodhimin e energjisë elektrike nga furnitoret vendas per pjesën e mbetur të vitit 2021 dhe vitit 2022 dhe si rrjedhojë edhe sasia e energjisë së blerë në Tregun e Lirë do të jetë e ndryshme nga ajo e parashikuar në aplikimin e dërguar,
 - b) Ka ndryshuar në mënyre të rrenjëhershme dhe drastike parashikimi për çmimin e blerjes së energjisë në Tregun e Lirë për pjesën e mbetur të vitit 2021 dhe për vitin 2022, si dhe çmimi i energjisë qe do të blihet nga prodhimi vendas për vitin 2022.
 - c) OSSH është akoma në pritje të daljes së shpejti të një Vendimi i Keshillit të Ministrave për ndryshimin e parashikimit të planin e humbjeve të energjisë elektrike sipas VKM 253 datë 24.04.2019 "Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik".
 - d) OSSH është njoftuar me propozimin për rritje të tarifës së transmetimit të energjisë nëpërmjet aplikimit të OST dhe duhet te përditesojë aplikimin me tarifen e propozuar.
- Aktualisht rrjeti i shpërndarjes përdoret nga shoqëritë e OSHEE Group sha në masën 99.1% (FSHU 72.6%, OSSH 26.2%, FTL 0.24%) dhe nga shoqëri të tjera vetëm 0.9%. Aplikimi është bazuar në rakordimet me FSHU, OSSH, FTL etj.
- Gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike sipas VKM nr. 584, date 08.10.2021 dhe VKM nr. 620, date 22.10.2021, deri në15 Prill 2022 nuk sjell ndryshime në parashikimet lidhur me kërkesën për të ardhura të OSSH për tarifën e vitit 2022.

2. Paraqisni informacion analitik për vitet 2020 - 2021 dhe parashikimin për 2022 për sa i përket shërbimeve kooperative të kryera nga OSHEE Group, duke i shoqëruar me kontratat

respektive dhe fatura të likujduara për periudhën sipërcituar si dhe duke argumentuar eficiencën e marrjes së këtyre shërbimeve nëpërmjet analizave kosto-përfitim krahasuar me koston e marrjes së tyre nga tregu.

Përgjigje:

Informacion analitik lidhur me parashikimet për shpenzimet korporative për vitin 2022 janë paraqitur në aplikimin për tarifa të shpërndarjes faqe 42 – 45.

Informacion i detajuar lidhur me përlllogaritjet për vitin 2020 është paraqitur në përgjigje të pyetjes 20 në përgjigje të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni” ku është dërguar bashkëngjitur kontrata e lidhur dhe në faturë e lëshuar nga OSHEE Group si shembull sipas kërkesës së ERE.

Ndërsa lidhur me kërkesën për analiza lidhur me kosto-përfitimin dhe mundësia e marrjes së shërbimeve nga tregu, gjatë seancës dëgjimore jemi përgjigjur se:

“Në kushtet kur ka kaluar vetëm një vit nga aplikimi i kontratave të shërbimit nuk mund të kryhen analiza profesionale krahasuese lidhur me plotësimin e këtyre shërbimeve nga tregu i lirë”

Planifikimi i shpenzimeve për shërbime korporative është bazuar tërësisht në kontratën e lidhur ndërmjet OSSH dhe OSHEE Grup për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Lidhja e kontratës dhe metodologjia e llogaritjes është bazuar në konsulencën me Zyrën për Implementimin e Reformës (RIO) në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila siguron gjithashtu ekspertizën konsulentëve të KFW dhe të Expertise France.

Sikundër përcaktohet në pikën 2 neni 3 të metodologjisë së llogaritjes së çmimeve të aprovuar nga palët ajo “mund të rishikohet dhe përmirësohet më tej në konsultim me ERE dhe palët e interesit të përfshira” dhe OSSH është gjithmonë e gatshme të kryejë të gjitha ndryshimet e nevojshme të dalta si përfundime të konsultimeve.

3. Shoqëria OSSH duhet të përcjellë në ERE informacion të detajuar dhe shpjegime sipas zërave për disa nga shpenzimet operative, të cilat pavarësisht se janë të përfshira në shërbimet korporative, realizohen edhe në mënyrë direkte nga shoqëria OSSH sh.a.

Përgjigje:

Sqaruar plotësisht në përgjigje të pyetjes 20 në përgjigje të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

4. Sqaroni kriteret e përdorura për përcaktimin e jetës operative të aseteve të cilat i përkasin aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe paraqisni listën e bazës së rregulluar të aseteve me kostot historike për çdo vit të periudhës 2015-2021 (pa marrë në konsideratë

rivlerësimin e tyre), duke evidentuar dhe normat përkatëse të amortizimit për cdo kategori aset
për cdo vit të periudhës 2015-2021.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 23-24 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”, është dërguar lista e plotë e aseteve të OSSH bashkë me normat e amortizimit të përdorura sipas organeve fiskale.

5. Në aplikim, konstatohet një rritje e konsiderueshme e kostos faktike të amortizimit për periudhën janar - gusht 2021 krahasuar me atë të planifikuar për këtë periudhë, të cilat sipas deklarimeve tuaja në seancën teknike, vijnë si rrjedhojë e përlllogaritjes së amortizimit të qerave financiare në fillim të vitit 2021. Sa më sipër, duhet të paraqisni në mënyrë të detajuar informacion për qeratë financiare në një pasqyrë të vecantë krahas bazës së rregulluar të aseteve në formë analitike për cdo aset si dhe plotësimin e kërkesave të mëposhtme:

- Listen e aseteve të cilat janë marrë me qera financiare
- Vlerën e secilit aset
- Normat e amortizimit të aplikuara për cdo aset
- Viti i marrjes së asetit
- Afatet për shlyerjen e qerave financiare
- Normat e Interesit për cdo kontratë
- Kopje të kontratave në format të skanuar.

Sa më sipër, duhet të përcillni informacion mbi vlerën kontabël të mjeteve të marra me qera financiare duke argumentuar dhe metodën e përdorur për amortizimin e tyre si dhe kriteret e përcaktimit të jetës ekonomike të dobishme. Argumentoni dhe paraqisni analiza mbi përlllogaritjet e vlerës së aseteve dhe amortizimit të qerave financiare për vitin 2022 duke i ndare ato nga asetet e tjera bashkë me normat dhe vlerat e amortizimit të parashikuara për cdo aset, si dhe paraqisni analizat tuaja mbi arsyet përse keni konsideruar marrjen e këtyre aseteve me qera financiare dhe jo duke i prokuruar ato në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Përgjigje:

Gjatë seancës dëgjimore kemi sqaruar se riklasifikimi i shpenzimeve për mjetet e marra me qera financiare nga shpenzimet operacionale në ato të amortizimit nuk ka efekt në llogaritjen e të ardhurës së kërkuar.

Informacione të detajuara lidhur me amortizimin e qerave financiare gjendet në dokumentin e dërguar të Raportit të Pasqyrave Financiare të Audituar të vitit 2020, Shënimi 18, faqe 33.

6. Paraqisni ne menyre te detajuar përlllogaritjet tuaja mbi koston e borxhit për vitin 2021 dhe vitin 2022, ku për te bere te mundur vlerësimin dhe analizimin e drejte lidhur me kete

komponent si edhe destinacionin e përdorimit të kredive të marra, sipas formatit të kërkuar në pikën 28 të shkresës m.925/5, datë 26.11.2021, OSSH sh.a duhet të përcjellë dhe informacionet si me poshte:

- evidenca krahasuese të normave të interesit për borxhin afatgjatë të shoqërisë ndaj normave tregtare të interesit për borxhin të pranuar nga kompanitë e tjera me risk të ngjashëm krediti.
- argumenta mbi qeliminimin e marrjes së kredive afatshkurtra dhe nëse ky borxh është konsideruar në llogaritjen e kostos së borxhit.

Përgjigje:

Informacione të detajuara lidhur me kreditë dhe llogaritjen e normës së interesit të borxhit janë paraqitur në Aplikim faqe 49, si dhe sqaruar në përgjigje të pyetjes 27 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

7. Lidhur me Normën e lejuar të kthimit mbi kapitalin e vet duhet të dërgohen argumenta dhe analiza lidhur me:

- arsyet e marrjes në konsideratë të riskut të vendit, ndërkohë që shoqëria OSSH sh.a është kompani vendase.
- referencat e përdorura për normën nominale të kthimit për letrat me vlerë me risk zero.
- përllogaritjen e Beta në nivelin 100% për kapitalin e vet duke evidentuar dhe përllogaritjet përkatëse apo referencat e konsideruara
- normën e kthimit të kapitalit, nëse është reale apo është sipas referencave të tregut.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 29 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

Risku i vendit është pjesë e përllogaritjes së tarifave edhe në republikën e Kosovës dhe pranuar nga ECRB (Energy Community Regulatory Board) i Komunitetit Europian.

OSSH është një shoqëri aksionere dhe jo buxhetore. Risku i vendit është pjesë e llogaritjes së kostos së kredive të marra nga bankat Shqiptare të cilat e heqin këtë risk vetëm në rastet kur është përdorur garancia sovranë me miratim të posaçëm të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

8. Sqaroni përse nuk është konsideruar nga ana juaj, llogaritja e një tarife kosto-reflektuese për mirëmbajtjen e përdoruesve të rrjetit pa konsum të energjisë elektrike, ku të identifikohen dhe përfshihen të gjitha kostot e mirëmbajtjes së rrjetit të shpërndarjes.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 22 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021
“Kërkesë për shtesë informacioni”.

9. Evidentoni sa është vlera e shpenzimeve për penalitete e shoqërisë për vitin 2020 dhe për 11 mujin 2021. Sqaroni arsyet e këtyre penaliteteve, të cilat edhe pse nuk përfshihen në përlllogaritjen e tarifës kanë ndikuar në fitim/humbjen e shoqërisë për këte periudhë.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 25 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021
“Kërkesë për shtesë informacioni”. Kosto e penaliteteve nuk njihet në kërkesën për të ardhura në tarifë.

10. Në përputhje me përcaktimet e pikes 4 te nenit 75 te Ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, date 06.09.2017, dhe kërkesave të "Rregullores se Procedurave te Paraqitjes dhe Miratimit te Planit te Investimeve" e miratuar me vendimin nr. 135/2017 te Bordit te ERE-s, risjellim në vëmendjen tuaj se duhet të paraqisni në ERE planin e investimeve që i korrespondon periudhës përkatëse rregullatore, të shoqëruar me relacionet shpjeguese, analizat kosto - përfitim dhe gjithë dokumentacionin mbështetës, si dhe përditesimin e planit 5-vjecar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 13 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021
“Kërkesë për shtesë informacioni”.

Me shkresën Nr.9505 Prot, datë 25.10.2021, kemi paraqitur Planin e Investimeve për vitin 2021 dhe përditësimin e Planit të Zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 5 vjecare (2018-2022) të shoqërisë OSSH sha, ne te cilen janë paraqitur Tabela e Planit të Investimeve për vitin 2021, Tabela e realizimit faktik të 6 mujorit të parë të vitit 2021, Tabela e përditësimit të Planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 5 vjecare 2018-2022 dhe Relacioni shpjegues për to.

Plani i 2022 i paraqitur është parashikuar 10.598 mld me investimet e domosdoshme, te cilat kerkojme te konsiderohen edhe ne kuadrin e aplikimit për tarifën e vitit 2022. Plani i Investimeve 2022 është lidhur me planin e 2021, pasi është vazhdimësia e investimeve të iniciuara.

Ne kuadrin e situatës së krijuar nga gjendja e jashtëzakonshme e furnizimit me energji elektrike, VKM 584/2021, frenimi i investimeve për shoqërinë, ku duhet të kryhen vetëm investimet që do të gjykojnë të domosdoshme, VKM e datës 10.12.2021 për ndryshimin e nivelit të humbjeve do të parashikohen në ndryshimet e nevojshme të planeve 2021-2022, 5 vjecarin 2018-2022, si dhe në përgatitjen e planit të 5 vjecarit të ardhshëm 2023-2027.

11. Dërgoni argumenta dhe evidenca mbi masat e marra prej jush në zbatim të VKM nr. 584, datë 08.10.2021, ku ndër të tjera kërkohet të pezulloni planet e investimeve për vitin 2021 dhe periudhën në vazhdim, me përjashtim të investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë duke koordinuar ushtrimin e aktivitetit tuaj, në përputhje me udhëzimet e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike.

Përgjigje:

Në zbatim të VKM nr. 584, datë 08.10.2021 është pezulluar puna për lidhjen e kontratave për investime të reja duke vazhduar vetëm me kontratat e lidhura dhe investimet e domosdoshme.

12. Në aplikimin e paraqitur, ndryshe nga vitet e mëparshme, konstatohet mungesë e të dhënave mbi impaktin e investimeve në rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar nga OSSH sh.a si dhe efektet në uljen e humbjeve në rrjet. Sa më sipër kërkohet të paraqisni:

- argumenta dhe sqarime mbi eficientecën teknike të realizimit të planit të investimeve të periudhave të mbyllura ushtrimore 2015-2020, të cilat janë përkthyer si shërbime cilësore për përdoruesit e rrjetit.
- analizë të plote mbi planin investimeve që priten të realizohen prej jush për çdo nivel tensioni si dhe efektin në planin e reduktimit të humbjeve të parashikuara në periudhat pasardhëse si kërkuar në shkresën nr. 925/5, datë 26.11.2021 për çdo nivel tensioni

Përgjigje:

Informacioni është pjesë e planit të investimeve paraqitur në ERE sqaruar në përgjigje të pyetjes 13 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

13. Bazuar në raportimet tuaja rezulton një grup prej 6300 klientesh, të cilët kanë pike lidhje në TM dhe matje në TU dhe kanë një cmir të ndryshëm të furnizimit me energji elektrike nga klientet në TM dhe ata TU. Argumentoni mënyrën e përdorur për kategorizimin e këtij grup klientesh, Sqaroni se si do të trajtohet kjo kategori klientesh dhe cili është propozimi juaj për tarifën e shpërndarjes së këtyre klienteve.

Përgjigje:

Çmimi i shitjes nuk është objekt i aplikimit të tarifave të shpërndarjes në nivel tensioni! Llogaritjet në aplikim kanë marrë përfshirë humbjen në nivel tensioni mbi të cilën ndërtohen tarifat. OSSH siguron të ardhura vetëm nëpërmjet tarifave dhe nuk ka tarifë të veçantë për TM – TU.

14. Argumentoni sa janë plotësuar kushtet teknike për daljen e klienteve të 20/10/6 kV në treg të lire dhe pritshmerite për realizimin e tyre deri në fund të vitit 2021.

- Numri i matesave intervalore dhe jo-intervalore që shërbejnë për matje dhe faturim të energjisë elektrike të konsumatoreve fundore sipas niveleve të tensionit, është sipas tabelës së mëposhtme:

Nivel Tensioni kV	Jo-Intervalore	Intervalore	Total
0.4 kV	108.500	3879	112.379
6 kV		152	152
10 kV		210	210
20 kV		320	320
35 kV		65	65
Shuma	108.500	4626	113.126

E dhëna e mesipërme dhe sqarimet e nevojshme janë vënë në dispozicionin tuaj edhe me shkresën Nr.4464/7, datë 05.01.2022.

- Numri i klientëve të cilët kanë plotësuar kushtet teknike për të dalë në treg të liberalizuar sipas tabelës së mëposhtme:

NIVELI I TENSIONIT	NR KONSUMATORE
20 kV	1,794
10 kV	2,821
6 kV	2,803
Grand Total	7,418

15. Nisur nga diskutimet në seancën degjimore teknike, përcillni argumenta dhe sqarime mbi arsyet e përfshirjes së demit ekonomik të faturuar në bilancin energjistik në kohën kur ERE është shprehur me vendimin e Bordit nr.90, datë 15.11.2010, lidhur me këtë çështje, Sqarojme se sasia e energjisë së faturuar si dem ekonomik nuk duhet të përfshihet në bilancin energjistik dhe si rrjedhojë nuk duhet të konsiderohet në parashikimet e sasive për të levruar në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2022. Në rast se kjo sasi është konsideruar prej jush në këto përlllogaritje atëherë përcillni në ERE korrigjimet përkatëse, Gjithashtu, paraqisni në formë (analitike të ardhurat e realizuara nga faturimi i demit ekonomik për vitet 2020 - 2021, të evidentuara për çdo nivel tensioni.

Përgjigje

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 16 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”. Dëmi ekonomik nuk planifikohet dhe nuk është përfshirë në llogaritjen e sasisë së energjisë në rrjet në bilancin energjitik.

16.Referuar raportimeve tuaja paraqitet nje sasi e energjisë elektrike, si energji e injektuar nga, HEC-et lokale ne rrjetin e transmetimit. Paraqisni akt-rakordimet me OST sh.a...ku evidentohet qarte dhe menyre te detajuar kjo sasi energjie për vitin 2020 dhe 2021, shpjegoni efektet teknike dhe ekonomike qe i shkaktohen OSSH sh.a nga ky fenomen si dhe masat e marra prej jush për minimizimin e ketyre efekteve gjate kesaj periudhe dhe periudhes ne vijim.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 5 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

Ne zbatim te detyrimeve ligjore shoqeria OSSH sha , iu ka percjelle problematikat, propozimet, veprimet konkrete teknike –ekonomike -ligjore te ndermara me qellim integrimin e BREE ne rrjetin shperndares me korrespondencat e meparshme.

Në prioritetet e saj, për përmbushjen e kërkesave të ligjit të energjise 43/2015, “Per Sektorin e Energjise Elektrike” te ndryshuar, ligjit 7/2017 “ Për nxitjen e përdorimit të energjise nga burimet e rinovueshme”, te ndryshuar, shoqeria OSSH sh.a bazuar në srategjinë e zhvillimeve të investimeve në zonat e BREE (për të gjitha nivelete e tensionit) ka studiuar dhe planifikuar kryerjen dhe vazhdimin e investimeve te cilat jane ende ne fazen emergjente dhe ka synuar sistemimin e kapaciteteve të medhaja prodhuese dhe minimizimin e fenomeneve negative të shfaqura në zonat shumë problematike (zonat e nxehta). Shoqeria OSSH sha ka ndjekur me perparesi qendrueshmerine e furnizimit te rrjetit shperndares per te pasur cilesi dhe shkalle te larte sigurie per aksesin e energji elektrike ne Sistemin Shperndares

17.Duke marre ne konsiderate ndarjen në tarifë për kapacitet dhe energji ne përputhje me rmetodologjine dhe aplikimin e shoqërisë OST sha, te cilin e gjeni te publikuar ne faqen zyrtare te ERE, duhet te paraqisni te dhenat mbi bilancin e pikut koincidues te fluksit te ngarkeses apo te shumes totale te te gjithë ngarkesave jo-koinciduese për grupet e klienteve sipas nivelit te tensionit.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 3 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

18.Sqaroni se përse shoqeria OSSH sh.a nuk ka aplikuar për një periudhe rregullatore 3 vjeç ne përputhje me metodologjine e tarifave te shpërndarjes.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 34 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

19. Përcillni ne ERE raportin për kalimin e detyrimeve te mbartura ne kuader te ndarjes ligjore te shoqërisë meme OSHEE sh.a dhe llogaritjen e korigjimit te te ardhurave qe i përkasin vetem OSSH sh.a, te deklaruar nga shoqeria si humbje nga ushtrimi i aktivitetit te shpërndarjes se energjisë elektrike si dhe argumentat e shpjegimet përkatëse si është bere ndarja e humbjes se periudhave paraadhese ushtrimore midis OSSH dhe FSHU sh.a.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 10 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”. Dërguar edhe dokumenti i auditorëve.

20.Paraqisni informacion mbi masat e ndermarra për rnylljen e maredhenieve te ndersjellta me OST dhe KESH, pagesat e kryera deri me tani dhe gjendja e mbetur e detyrimeve, si dhe marreveshjet respektive lidhur me planin e shlyerjes se ketyre detyrimeve me secilen pale.

Përgjigje:

Detyrimet ndaj OST dhe KESH për vitin 2021 do të paguhen sipas planit të parashikuar dhe marrëveshjeve të lidhura, sapo kredia e akorduar nga EBRD të behet aktive në ditët e para të vitit 2022.

Kopje të marrëveshjeve të lidhura me KESH dhe OST për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura do ti gjeni bashkelidhur

21.Paraqisni ne menyre analitike shpenzimet e mirembajtjes për periudhen 2.020-2021 te ndara ne shpenzimet mirembajtje, te cilat nuk rrisin jetegjatesine e asetëve, duke përfshire kostot deri ne 1,000,000 leke,

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 21 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”. Dërguar edhe informacione shtesë.

22. Paraqisni të gjitha tabelat dhe evidencat e paraqitura në aplikim si dhe në korrespondencat respektive në formatin excel bashkë me formulat përkatëse.

Përgjigje:

Sqaruar në përgjigje të pyetjes 35 të kërkesës së ERE Nr.925/5 Prot. datë 26.11.2021 “Kërkesë për shtesë informacioni”.

Me konsideratë,

Petraq LIKA

Administrator

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A.



Nr. 208 Rep.
Nr. 87 Kol

**MARRËVESIJE PËR SHLYERJEN E
DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA**

Sot, më datë 06.10.2018 (dy mijë e
tetëmbëdhjetë), unë,

• **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a.**,
person juridik i regjistruar në Shqipëri, me
numër identifikimi unik të biznesit (NIPT):
J61817005F, me adresë ligjore në: Rruga Eshref
Frashëri, Kompleksi Vizion, Nr .8, Njësia
Bashkia Nr.11, Tiranë, e përfaqësuar në mënyrë
të rregullt nga z. Agron Hetoja përfaqësues ligjor
i Kompanisë, me dokument identifikimi
(më poshtë referuar si "KESH" ose "Kreditori");

• **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë
Elektrike sh.a.**, person juridik i regjistruar në
Shqipëri, me numër identifikimi unik të biznesit
(NIPT): K72410014H, në adresën: Bulevardi
"Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, II. 1, Njësia
Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, përkohësisht
i përfaqësuar nga z. Adrian Çela, përfaqësues
ligjor i Kompanisë, me dokument identifikimi
(më poshtë referuar si "OSHEE" ose "Debitori");

Secila nga palët e mësipërme referohet në vijim,
veçamas si "Pala" dhe së bashku si "Palët"

HISTORIKU:

(A) Kreditori dhe Debitori kanë hyrë në disa
marrëveshje tregtare për shitjen e energjisë nga
kreditori tek debitori, gjatë periudhës nga 2008

**AGREEMENT FOR REPAYMENT OF
ARREARS**

Today, on 06.10.2018 (two thousand and
eighteen), I,

• **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a.** a
legal entity registered in Albania, registered with
unique business identification number (NUIS):
J61817005F, having its legal address at: Rruga
Eshref Frashëri, Kompleksi Vizion, Nr.8, Njësia
Bashkiake Nr.11, Tiranë, duly represented by Mr.
Agron Hetoja legal representative of the
Company, with identification document (ID Card)
(hereinafter referred to as "KESH" or the
"Creditor");

• **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë
Elektrike Sh.a.**, a legal entity, registered with
unique business identification number (NUIS):
K72410014H, having its legal seat at the address:
Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, II. 1,
Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirana, duly
represented by Mr. Adrian Çela, legal
representative of the Company, with identification
(hereinafter referred to as "OSHEE" or the
"Debitor");

Each of the parties above is referred separately
as "a Party" and collectively as "the Parties"

BACKGROUND:

(A) The Creditor and the Debitor have entered in
several commercial agreements for the sale of
energy from the Creditor to the Debitor, during the

deri në 2016 ("Shitjet").

(B) Debitori nuk ka kryer pagesat që rrjedhin nga Blerja e Energjisë për shumën e mbetur pa paguar dhe penalitetet për pagesat e vonuara. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Debitori do të jetë përgjegjës për pagesat që rrjedhin nga Faturat e Prapambetura të Blerjes së Energjisë që Debitori i detyrohet Kreditorit, shuma e të cilave, në bazë të pasqyrave financiare të audituara dhe të publikuara të KESII për vitin 2016, kanë arritur vlerën prej 51,438,460,429 Lekë ("Detyrimi"). Ky borxh përbëhet nga 40,853,480,443 (dyzet miliard e tetëqind e pesëdhjetë e tre milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e nëntë) lekë për fatura shitjeje energjie dhe 10,584,979,986 (dhjetë miliard e pesëqind e tetëdhjetë e katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë për penalitete.

Kjo vlerë e detyrimit dhe skeduli përkatës i shlyerjes (këstet për periudhën 2032 e në vijim) si referuar në Aneksin 1 do të jenë objekt ndryshimesh bazuar në rezultatet e zbatimit të Urdhrit të Kryeministrit nr. 17 të datës 23/01/2018.

(C) Kreditori është i detyruar në zbatim të marrëveshjes së huasë lidhur midis KESII-it dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZII), nënshkruar më 30 qershor 2016, për projektin e Ristrukturimit të KESII-it ("Marrëveshja e Huasë") që të mbajë një Raport të Mbulimit të Shërbimit të Borxhit (DSCR/RMSIIB) prej 1.2x gjatë gjithë kohës. DSCR /RMSIIB nënkupton, për çdo periudhë, raportin e (i) Flukseve Monetare të Disponueshme për Shërbimin e Borxhit për një Vit Financiar, duke përfshijtur fitimet dhe humbjet e jashtëzakonshme, me (ii) shumën e ripagesave të principalit dhe interesit për të gjitha Borxhet Financiare aktuale ose të krijuara gjatë kësaj periudhe. Flukset monetare të disponueshme për shërbimin e borxhit do të quhen, për çdo vit financiar, i gjithë fluksi i parasë nga aktivitetet operacionale të KESH siç përcaktohet sipas SNRF në pasqyrat financiare të audituara të KESH-it, plus çdo interes të paguar gjatë periudhës, minus çdo shpenzim kapital plus çdo borxh të lërhequr për të financuar shpenzimet kapitale të lartpërmendura në periudhën e dhënë. Viti

period from 2008 to 2016 (the "Sales").

(B) The Debtor has not performed the payments related to the Energy Purchases at the outstanding amount and the Penalties for delayed payments. According to this Agreement the Debtor will be responsible for the payments related to the Outstanding Energy Purchase Bills which is due from the Debtor to the Creditor which based on published KESII audited financial statements for year 2016 has reached the value of 51,438,460,429 Lek (the "Debt"). This debt consists of 40,853,480,443 (fourty billion and eight hundred fiftythree million and fourhundred eighty thousand and fourhundred forty three) Lek as energy bills and 10,584,979,986 (ten billion fivehundred eightyfour million ninehundred seventynine thousand ninehundred eightysix) Lek as penalties.

This debt value and the respective repayment schedule (installments for the period 2032 onwards) referred to in Annex 1 shall be subject of amendments following the outcome of the Prime Minister Order no. 17 dated 23/01/2018.

(C) The Creditor is bound by the loan agreement between KESH and the European Bank for Reconstruction and Development (EBRD), signed on the 30 June 2016, for the KESII Restructuring project (the "Loan Agreement") to maintain a minimum Debt Service Coverage Ratio (DSCR) of 1.2x at all times. DSCR means, for any period, the ratio of (i) Cash Flows Available for Debt Service for a Financial Year, excluding exceptional gains and losses, to (ii) the sum of the principal repayments and interest payments on all Financial Debt due or accrued during such period. Cash Flows Available for Debt Service means, in respect of any Financial Year, all cash flow from operating activities of KESH as determined under IFRS in KESH's audited financial statements, plus any interest paid during the period, minus any capital expenditure plus any debt drawn down to finance the aforementioned capital expenditure in the period. A Financial Year is any 12 months period for which audited financial statements for KESII are prepared by external auditors in accordance with IFRS. Financial Debt shall have the meaning given to "Debt" in Section 4.03 a) of the Loan Agreement

Financiar është çdo periudhë 12 mujore për të cilën janë përgatitur nga auditorët e jashtëm, pasqyrat financiare të audituara të KESTI, në përputhje me SNRF. Borxhi Financiar do të ketë kuptimin e dhënë në 'Borxhi' në Seksionin 4.03 a) të Marrëveshjes së Huasë.

(D) Me qëllim që Debitori të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjeve që lidhen me shitjet dhe të paguajë detyrimin ndaj Kreditorit, palët kanë si qëllim të pranojnë këtë Marrëveshje duke vendosur kushtet dhe afatet për shlyerjen e shumave të paguara të detyrimit.

Në vijim të sa më sipër, Palët bien dakord për sa vijon:

1. Qëllimi i Marrëveshjes

Kreditori dhe Debitori nënshkruajnë këtë Marrëveshje me qëllim shlyerjen e plotë, të pakushtëzuar dhe përfundimtare të të gjithë detyrimit nga Debitori tek Kreditori në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe të Skedulit të Ripagimit të bashkangjitur këtu.

2. Pagesa e detyrimit

2.1. Palët bien dakord që Debitori të paguajë të gjithë detyrimin në pagesa vjetore, duke filluar nga viti 2018 derisa ky detyrim të shlyhet plotësisht, të strukturuar në mënyrë të atillë që Kreditori të përmbushë një DSCR/RMSHB minimale prej 1.2x për vitin financiar paraardhës ("Plani i Pagesave").

2.2. Çdo pagesë vjetore, me përjashtim të vitit 2018, do të strukturohet si shuma e përbërë nga një pjesë fikse dhe një pjesë të ndryshueshme në mënyrë që:

2.2.1. Pjesa fikse të jetë e barazvlefshme me këstin EUR sipas planit të shlyerjes në Shtojcën 1. Pjesa fikse do të paguhet në ALL sipas kursit të këmbimit të BSII-së në datën e pagesës (Pjesa Fikse).

2.2.2. Pjesa e ndryshueshme është diferenca e fluksit të nevojshëm të parave që i duhet Kreditorit për të përmbushur një DSCR minimale prej 1.2x për vitin paraardhës me pjesën Fikse, kur kjo diferencë është më e madhe se zero ("Pjesa e Ndryshueshme").

Debitori i paguan Kreditorit Pjesën e Ndryshueshme me kusht që Kreditori të ketë

(D) In order for the Debtor to fulfil its obligations under the agreements related to the Sales and to pay the Debt towards the Creditor, the Parties hereby intend to enter in this Agreement setting the terms and conditions for the repayment of the outstanding amounts of the Debt.

Pursuant to the above, the Parties agree as follows:

1. Purpose of the Agreement

The Creditor and the Debtor, are entering into the present Agreement in view of the fully, unreservedly and final repayment of all the Debt by the Debtor to the Creditor in accordance with the terms and conditions of this Agreement and of the Repayment Schedule attached herein.

2. Payment of the Debt

2.1. The Parties agree that the Debtor shall pay the entire Debt in annual payments, starting in 2018 and until the Debt is fully repaid, structured so that the Creditor meets a minimum DSCR of 1.2x for the prior financial year (the Payment Schedule).

2.2. Each annual payment, with the exception of 2018, will be structured as the sum of a fixed portion and a variable portion so that:

2.2.1. The fixed portion is equivalent of EUR Installment as per repayment schedule in Annex 1. Fixed portion will be paid in ALL currency as per BoA Exchange rate at payment date (the "Fixed Portion").

2.2.2. The variable portion is the difference of the cash needed by the Creditor to meet a minimum DSCR of 1.2x for the prior year, and the Fixed Portion, where such difference is greater than zero (the "Variable Portion").

The Debtor shall pay to the Creditor the Variable Portion under condition that the Creditor has made all efforts to meet this Ratio by having previously used all the Reserved Fund established according to the Council Ministers Decision nr.729 date 08.12.2017.

bërë të gjitha përpjekjet për të përmbushur DSCR duke përdorur më parë të gjithë Fondin e Rezervës të themeluar sipas Vendimit të Ministrave të Këshillit nr.729, datë 08.12.2017.

Nëse diferenca e fluksit të nevojshëm të parave që i duhet Kreditorit për të përmbushur një DSCR minimale prej 1.2x për vitin paraardhës, me Pjesën Fikse është më pak se zero, Kreditori nuk do të rimorsojë Debitorin për një ndryshim të tillë. Pjesa e ndryshueshme do të fillojë të aplikohet nga viti 2019 dhe në vijim, derisa detyrimi të ripaguhet plotësisht. Pjesa e ndryshueshme do të llogaritet nga KESIT dhe do të vlefësohet në raportin e auditorëve për auditimin e pasqyrave financiare për vitin financiar të audituar sipas SNK.

Secila nga pagesat do t'i ofrohet Kreditorit në një kështë vjetor të pagueshëm në 1 Tetor deri në vitin 2022 dhe duke filluar nga viti 2023 pagesat do të kryhen në dy kështë gjashtëmujore, të pagueshme më 1 Prill dhe 1 Tetor.

2.2. Në rast se Debitori nuk kryen ndonjë pagesë brenda afatit të caktuar për pagesën sipas Planit të Pagesave, Kreditori mund t'i dërgojë një njoftim Debitorit me anë të të cilit kërkon kryerjen e pagesës brenda 10 ditëve nga data e caktuar në Planin e Pagesave. Për shmangien e çdo dyshimi, në rast se asnjë pagesë nuk është kryer sipas Planit të Pagesave, kjo menjëherë do të përbëjë rast shkakësor sipas nenit 6 më poshtë dhe njoftimi për Debitorin nuk do të konsiderohet si i detyrueshëm për t'u zbatuar nga kreditor, por vetëm një alternativë në diskrecionin e tij.

2.3. Debitori, për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë gjithë periudhës kohore të kërkuar për pagesën si përcaktuar në Planin e Pagesave, do të hapë dhe mbajë një llogari bankare brenda një banke të rënë dakord nga Palët, ku Debitori duhet të ketë depozituar një shumë jo më të vogël se "Kësti vjetor i vitit përkatës sipas Aneksit 1" me qëllim garantimin e pagesës së detyrimit sipas Planit të Pagesave ("Llogaria Escrow"). Debitori do të hapë llogarinë escrow brenda 60 ditësh nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje. Detyrimi i Debitorit për të filluar menjëherë pagesën sipas Planit të Pagesave nuk do të ndikohet nga data e hapjes së Llogarisë Escrow.

2.4. Debitori me anë të kësaj Marrëveshjeje, autorizon Kreditorin, si dhe do të ndërmarrë të

If the difference between the cash needed by the Creditor to meet a DSCR of 1.2x for the prior year and the Fixed Portion is less than zero, the Creditor will not reimburse the Debtor for such difference. The Variable Portion shall start to apply in 2019 and thereafter until the Debt is fully repaid. The Variable Portion shall be calculated by KESIT and shall be validated in the auditors' report on audited financial statements for IFRS purposes, for the Financial Year.

Each of the payments will be provided to the Creditor in one annual installment on the 1st of October till year 2022, and starting from year 2023 the payments will be two semi-annual instalments, payable on the 1st of April and 1st of October.

DATE 06.04.2018, FOR REPAYMENT OF
ARREARS**

Today, on ___./___./2021 (two thousand and twenty one), I, _____ Notary Public, with office in Tirana, at _____, upon the request of the parties drafted and legalized this amendment Agreement of the agreement for the Repayment of Arrears (the "Agreement") as below:

- **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a.** a legal entity registered in Albania, registered with unique business identification number (NUIS): J61817005F, having its legal address at: Rruga Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë, duly represented by Mr. Ergys VERDHO legal representative of the Company, with identification document (ID Card) No. 035624020, Personal No. H40501267D issued on date 15.01.2020, (hereinafter referred to as "KESH" or the "Creditor");
- **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a.**, a legal entity, registered with unique business identification number (NUIS): K72410014H, having its legal seat at the address: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirana, duly represented by Mr. Adrian ÇELA, legal representative of the Company, with identification document (ID Card) No. 033853838, Personal No. G70226165H issued on date 26.01.2019, (hereinafter referred to as "OSHEE" or the "Debtor");

Each of the parties above is referred separately



HISTORIKU:

(A) Kreditori dhe Debitori kanë hyrë në disa marrëveshje tregtare për shitjen e energjisë nga kreditori tek debitori, gjatë periudhës nga 2008 deri në ditën e kësaj marreveshjeje ("Shitjet").

(B) Debitori nuk ka kryer pagesat që rrjedhin nga Blerja e Energjisë për shumën e mbetur pa paguar dhe penaltitetet për pagesat e vonuara. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Debitori do të jetë përgjegjës për pagesat që rrjedhin nga Faturat e papaguara të Blerjes së Energjisë që Debitori i detyrohet Kreditorit, shuma e të cilave, në bazë të aktrakordimit bashkëlidhur dhe pjesë e kësaj marreveshjeje, kanë arritur vlerën prej 48,910,915,441.90 Lekë ("Detyrimi").

(C) Mes palëve është nënshkruar më date 06.04.2018, Marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Në pikën 15.1 të kësaj marreveshjeje parashikohet se palët mund të ndryshojnë marrëveshjen me miratim mes tyre.

(D) palët kanë evidentuar se që nga 01.01.2017, pas nënshkrimit të marrëveshjes e deri më sot, nga palët janë kryer veprime të cilat sjellin si nevojë rishikimin me ndryshim të marreveshjes bazë edhe me plotësimin e detyrimeve të tjera akumuluar mes palëve, pas dates 01.01.2017.

(E) palët kanë treguar vullnetin paraprak dhe kanë diskutuar mundësitë dhe nevojat për ndryshimin e marreveshjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe në vijim vlerësojnë si të nevojshme ndryshim e marrëveshjes.

(F) Palët kanë realizuar mes tyre në zbatim të akt rakordimit këtu bashkëlidhur marrëveshjet e shuarjes me kompesim të detyrimeve reciproke të akumuluar.

(G) Asambleja e Aksionerëve të palëve nëpërmjet një plani veprimi, ka kërkuar që të realizohet nga palët ndryshimi parashikimeve të marreveshjes duke e aktualizuar atë me detyrime aktuale mes shoqërive, referuar Urdhërit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe

as "a Party" and collectively as "the Parties"

BACKGROUND:

(A) The Creditor and the Debtor have entered in several commercial agreements for the sale of energy from the Creditor to the Debtor, during the period from 2008 to the day of this agreement (the "Sales").

(B) The Debtor has not performed the payments related to the Energy Purchases at the outstanding amount and the Penalties for delayed payments. According to this Agreement the Debtor will be responsible for the payments related to the Outstanding Energy Purchase Bills which is due from the Debtor to the Creditor which based on the reconciliation act attached and part of this agreement in the value of 48,910,915,441.90 Lekë (the "Debt").


(C) Between the parties on 06.04.2018, has been signed an Agreement for repayment of arrears. Paragraph 15.1 of this agreement provides that the parties may amend the agreement with their consent.

(D) the parties have identified that from 01.01.2017, after signing the agreement until today, the parties have taken actions from which an amendment of the agreement is necessary adding new obligations accumulated between the parties, after 01.01.2017.

(E) The parties have showed their willingness and discussed the possibilities and needs for the amendment of arrears repayment arrangement and then consider as necessary its amendment.

(F) The parties have concluded with each other based on the act of reconciliation hereby attached, Net off agreements (termination with compensation of obligations) of the accumulated mutual obligations.

(G) Assembly of Shareholder of the parties through an action plan, has requested to the parties to amend the provisions of the agreement by updating it with current obligations between the companies, referring to the Joint Order of the Ministry of Finance and Economy and the Ministry of Infrastructure and Energy No. 304, dated



Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 304, datë 17.12.2020

Në vijim të sa më sipër, Palët bien dakord për sa vijon:

1. Qëllimi i Marrëveshjes

Kreditori dhe Debitori nënshkruajnë këtë shtojcë me qëllim realizimin e disa ndryshimeve në Marrëveshjen e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018..

Kjo shtojcë lind si nevojë e përditësimit të marrëdhënies mes palëve bazuar në ndryshimet e ndodhura pas hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018,

2. Përcaktimi i detyrimeve mes palëve

2.1. Palët evidentojnë dhe dakordësojnë se gjatë periudhës që nga data 31.12.2016, periudhë e marrë si reference për përcaktimin e detyrimeve reciproke për hartimin e marrëveshjes me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, deri në lidhjen e akt rakordimit të datës 31.12.2020, ka patur në menyrë reciproke, mospërbushje detyrimesh të tjera, të pa përfshira dhe që cilat sjellin ndryshime në shumën e detyrimit objekt i marrëveshjes me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018.

2.2 Debitori, pranon se që nga data 01.01.2017 dhe përgjatë zbatimit të marrëveshjes Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, nga ane e tij ka patur mospërbushje të disa detyrimeve korentë ndaj Kreditorit.

2.3 Kreditori pranon se që nga data 01.01.2017 dhe përgjatë zbatimit të marrëveshjes Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, nga anë e tij ka patur mospërbushje të disa detyrimeve korentë ndaj Debirotit.

2.4 Palët bien dakort që të saktësojnë detyrimin objekt marrëveshje nëpërmjet kësaj shtojcë të marrëveshjes me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, duke bërë ndryshime të saj.

2.5 Palët për qëllime të rakordimit të detyrimeve

17.12.2020.

Pursuant to the above, the Parties agree as follows:

1. Purpose of the Agreement

The Creditor and the Debtor, are entering into the present Agreement with the scope to amend the Agreement for Repayment of Arrears No. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018.

This appendix comes as a need to update the relationship between parties based on changes occurred after the drafting and signing of agreement no. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018,

2. Definement of obligation between parties.


2.1. The Parties highlight and agree that since 31.12.2016, the period taken as a reference for designation of mutual obligation and drafting the agreement with No. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018, for Repayment of arrears, until the signing of reconciliation act, there has been from both parties, new non-fulfillment of obligations, not included and which effects the amount of debt subject of the agreement no. 208 Rep., No. 97 Kol. Date 06.04.2018.

2.2 The debtor acknowledges that from date 01.01.2017 and during the implementation of the agreement no. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018, on his part there has been non-compliance with some current liabilities to the Creditor.

2.3 The creditor acknowledges that from date 01.01.2017 and during the implementation of agreement no. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018, on his part there has been non-fulfillment of some current obligations to Debirot.

2.4 Parties agree to specify the mutual obligations through changes in the agreement with No. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018, making amendment of it.

2.5 The parties, for the purposes of reconciliation of obligation and amendment of this agreement, have performed an act of reconciliation attached and part of this amending agreement defining the total



dhe ndryshimit të kësaj marrëveshjeje, kanë realizuar aktin e rakordimit bashkëlidhur dhe pjesë të kësaj shtojcë, duke përcaktuar shumën totale të detyrimit që debitori i detyrohet kreditorit, në datën e efektivitetit të kësaj marrëveshjeje në shumën prej 48,910,915,441.90 Lekë.

2.6 Palët kanë realizuar mes tyre në zbatim të aktit rakordimit të detyrimeve të datës 31.12.2020, marrëveshjet e shuarjes me kompesim të detyrimeve (marrëveshje netimi detyrimesh) reciproke të akumuluarra, me Nr. 2316 Prot. KESH sh.a. dhe Nr. 4066 Prot., OSHEE sh.a., datë 22.04.2021.

3. Ndryshimet në marrëveshjen ekzistuese.

3.1 Palët bien dakort që ndryshimet në marrëveshjen ekzistuese të fillojnë efektet në datën e 31.12.2020, datë në të cilën mes palëve është hartuar aktrakordimi i detyrimeve të ndërsjellta, Nr. 3985 Prot., OSHEE sh.a. dhe Nr. 2282 Prot., KESH sh.a. datë 20.04.2021.

3.2 Palët bien dakort që ndryshimet në marrëveshjen Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018, Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të realizohen në skedulën e ripagimit, Aneksi I, si bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje ndryshuese, ankes i cili bëhet pjesë e marrëveshjes kryesore.

3.4 Te gjithë parashikimet e tjera të marrëveshjes me Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., datë 06.04.2018, mbeten të pa ndryshuara.

4. Deklarimi dhe Garancitë e Debitorit

4.1. Debitori bie dakort se detyrimet e tij ndaj kreditorit janë ato si të përcaktuara në aktin e rakordimit dakordësuar mes palëve dhe pjesë e kësaj marrëveshjeje.

4.2. Debitori nuk do të ngrejë asnjë pretendim, të drejtë, kërkesë ose ankesë lidhur me ekzistencën e detyrimit dhe cilësinë e tij si Debitor ndaj Kreditorit.

4.3 Debitori premton dhe merr përsipër të kryejë pagesën e detyrimit në përputhje me shumën dhe afatet e specifikuar në Planin e Pagesave të

amount of obligation of the debtor to the creditor, at the date of effectiveness of this agreement, in the amount of 48,910,915,441.90 Leke.

2.6 The parties have concluded with each other based on the act of reconciliation act for obligation on 31.12.2020, Net off agreements (termination with compensation of obligations) of the accumulated mutual obligations, No. 2316 Prot. KESH sh.a. and Nr. 4066 Prot., OSHEE sh.a., date 22.04.2021

3. Amendment to the existing agreement.

3.1 The parties agree that changes to the existing agreement will take effect on the date of signature of this amending agreement No. 3985 Prot., OSHEE sh.a. and Nr. 2282 Prot., KESH sh.a. date 20.04.2021.

3.2 The parties agree that the changes in the agreement no. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018, For the settlement of the overdue obligations to be realized in the repayment schedule, Annex 1 of the agreement, as attached to this amending agreement, annex that will be part of the main agreement.

3.4. All other provisions of the agreement with No. 208 Rep., No. 97 Col., dated 06.04.2018, remain unchanged.


4. Declaration and Warranties of the Debtor

4.1. The debtor agrees that his obligations to the creditor are those defined in the act of reconciliation agreed between the parties and part of this agreement.

4.2. The Debtor shall not raise any claim, right, claim or complaint regarding the existence of the obligation and its quality as a Debtor to the Creditor.

4.3 The Debtor promises and undertakes to perform the payment of the Debt in accordance with the amounts and terms specified in the Payment Schedule attached to this Agreement and agreement No. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, as amended.

4.4. The Debtor shall all the time fulfill the



bashkangjitur në këtë Marrëveshje dhe marrëveshjes Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, e ndryshuar.

4.4. Debitori duhet të përmbushë të gjitha detyrimet sipas paragrafëve 2.4, 2.5; 2.6 dhe 2.7, të marrëveshjes për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018

4.5. Debitori, me anë të kësaj Marrëveshjeje garanton, njeh dhe pranon që të gjitha shumat e detyrimit ndaj Kreditorit janë të sakta, dhe shprehimisht pa kushte e pranon cilësinë e tij si Debitor ndaj kreditorit për shumën e detyrimit dhe se nuk ka pretendime, të drejta, kërkesa, ankesa dhe / ose ndonjë shkaqe të tjera të pretendimi të çfarëdo natyre, që rrjedhin nga ose në lidhje me detyrimin ose cilësinë e tij si Debitor..

5. Data e Hyrjes në Fuqi dhe Përfundimi i Marrëveshjes

5.1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi sapo të jetë nënshkruar nga të gjitha Palët ("**Data e Hyrjes në Fuqi**") në prani të një noteri publik dhe do të mbarojë pasi të jenë paguar plotësisht pagesat që lidhen me detyrimin sipas Planit të Pagesave.

6. Ndryshimi i Marrëveshjes për ripagimin e detyrimeve të prapambetura

6.1 Kjo marrëveshje ndryshuese është pjesë e marrëveshjes kryesore Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe të gjithë anekset e kësaj marrëveshjeje bëhen pjesë e marrëveshjes kryesore.

6.2 Të gjithë parashikimet e marrëveshjes kryesore Nr. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018, Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, që nuk janë ndryshuar nga kjo marrëveshje ndryshuese mbeten në fuqi dhe janë të detyrueshme për palët.

7. Komunikimi

Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera nën ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të jepen me shkrim dhe, përveç nëse parashihet ndryshe ose kërkohet nga Ligji Shqiptar, mund të bëhet me e-

obligations as per paragraphs 2.4, 2.5; 2.6 and 2.7 of the Agreement for repayment of arrears, No. 208 Rep., Nr. 97 Kol., date 06.04.2018.

4.5. The Debtor hereby guarantee, acknowledge and accepts the following that all the amounts of the Debt towards the Creditor are correct and it expressly and unconditionally acknowledges and accepts its quality as Debtor towards the Creditor for the amount of the Debt and that it does not have claims, rights, demands, complaints, and/or any other causes of action of whatever nature, arising from or in connection with the Debt or its quality as Debtor.

5. Entry into force date and Termination of Agreement

5.1. This Agreement shall enter into force once it has been signed by all Parties (the "**Effective Date**") in the presence of a Notary and shall expiry after all the payments related to the Debt as per the Payment Schedule has been fully paid.

6. Amendment of agreement for repayment of arrears

6.1 This amending agreement is part of the main agreement no. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018, For the repayment of arrears and all annexes of this amendment agreement will become part of the main agreement.

6.2 All the provisions of the main agreement no. 208 Rep., No. 97 Kol., dated 06.04.2018, For the repayment of arrears, which have not been amended by this amending agreement, remains into force.

7. Communication

All notices or other communications under or in connection with this Agreement shall be given in writing and, unless otherwise stated or required by the Albanian Law, may be made by e-mail and/or facsimile. Any such notice shall be deemed to be given when the e-mail or facsimile is received by the addressee, provided that a notice received on a



mail dhe / ose faks. Çdo njoftim i tillë do të konsiderohet i dhënë kur e-mail ose faksimili të merret nga marrësi, me kusht që një njoftim i marrë në një Ditë Jo pune të konsiderohet të jepet në Ditën e ardhshme të Punës. Çdo njoftim i një Rasti Shkakësor duhet, përveç kësaj, të jepet me anë të postës së certifikuar.

Komunikimi do të trajtohet si vijon:

a) Për Kreditorin:

Në vëmendjen e :

Adresë:

e-mail:

Fax:

(b) Për Debitorin:

Në vëmendjen e:

Adresë

e-mail:

Fax:

8. Ligji I zbatueshëm dhe juridiksioni

8.1. Kjo marrëveshje hartohet dhe interpretohet në përputhje me parashikimet e ligjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe palët, nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, bien dakord të jenë nën juridiksionin e gjykatave Shqiptare.

19. Palët

Kjo Marrëveshje hartohet në 5 (pesë) kopje secila me vlerë të njëjtë, në gjuhën Shqipe dhe Anglisht. Në rast mosmarrëveshje apo interpretimi do të merret në konsideratë version në gjuhën Angleze.

NË VIJIM TË SA MËSIPËR, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre përkatës, në datën dhe vitin e cilësuar në fillim të aktit, shkruar përpara Noterit Publik në Tiranë, Republika e Shqipërisë.

non Business Day is deemed to be given on the next Business Day. Any notice of an Event of Default shall, in addition, be given by certified mail.

Communication shall be addressed as follows:

a) If to the Creditor:

Attention:

Address:

e-mail:

Fax:

(b) If to the Debtor:

Attention:

Address

e-mail:

Fax:

8 Governing Law and Jurisdiction


8.1. This agreement shall be governed by and construed in accordance with the laws of the Republic of Albania and the parties hereto submit to the Jurisdiction of the Albanian Courts.

19. Counterparts

This Agreement is executed in 5 (five) copies each having the same value, written in Albanian and English language. In case of misunderstanding or interpretation the English version of the agreement will prevail.

IN WITNESS WHEREOF, the parties, acting through their respective duly authorised representatives, have caused this Agreement to be signed in their respective names, as of the date and year first above written in front of the Public Notary, in Tirana, Republic of Albania.

I, the notary, as I read this act loud and clear, which



Unë noteri, pasi ua e lexoj me zë të lartë e të qartë aktin, të cilin palët deklarojnë se e kuptuan përmbajtjen dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plote dhe e nënshkruajnë rregullisht para meje, e legalizojë në bazë të ligjit.

the parties state that they understood the content and found it in accordance with their free and full will and sign it regularly before me, legalize it in accordance with the law.

THE SIGNING PARTIES:

PËR LLOGARI TË KESH SH.A.

PËR LLOGARI TË OSHEE SH.A.

FOR AND ON BEHALF OF KESH SH.A

FOR AND ON BEHALF OF OSHEE SH.A

**ERGYS VERDHO,
ADMINISTRATOR**

CHIEF EXECUTIVE OFFICER

Erqys Verdho

**ADRIAN ÇELA,
ADMINISTRATOR**

CHIEF EXECUTIVE OFFICER

Adrian Çela

**NOTERI PUBLIK
NOTARY PUBLIC**

Notary Public Signature



ANEKSI 1 | ANNEX 1
SKEDULI I RIPAGIMIT | REPAYMENT SCHEDULE

Kursi korent | shkembimit | Current Exchange rate: 1 EUR = 133 ALL

SKEDULI I RIPAGIMIT REPAYMENT SCHEDULE			
Viti Year	Pjesa fikse Fixed portion ne in EUR	Pjesa fikse Fixed portion ne in ALL	Vlera e mbetur Outstanding balance ne in ALL
			48,910,915,441.90
2021	17,116,244.00	2,276,460,452.00	46,634,454,989.90
2022	16,984,752.00	2,258,972,016.00	44,375,482,973.90
2023	16,853,260.00	2,241,483,580.00	42,133,999,393.90
2024	16,725,661.00	2,224,512,913.00	39,909,486,480.90
2025	16,590,276.00	2,206,506,708.00	37,702,979,772.90
2026	16,458,784.00	2,189,018,272.00	35,513,961,500.90
2027	16,327,292.00	2,171,529,836.00	33,342,431,664.90
2028	16,197,962.00	2,154,328,946.00	31,188,102,718.90
2029	16,064,308.00	2,136,552,964.00	29,051,549,754.90
2030	15,932,815.00	2,119,064,395.00	26,932,485,359.90
2031	15,801,323.00	2,101,575,959.00	24,830,909,400.90
2032	17,287,408.00	2,299,225,264.00	22,531,684,136.90
2033	11,031,983.00	1,467,253,739.00	21,064,430,397.90
2034	11,031,983.00	1,467,253,739.00	19,597,176,658.90
2035	11,031,983.00	1,467,253,739.00	18,129,922,919.90
2036	11,031,983.00	1,467,253,739.00	16,662,669,180.90
2037	11,031,983.00	1,467,253,739.00	15,195,415,441.90
2038	11,031,983.00	1,467,253,739.00	13,728,161,702.90
2039	11,031,983.00	1,467,253,739.00	12,260,907,963.90
2040	11,031,983.00	1,467,253,739.00	10,793,654,224.90
2041	11,031,983.00	1,467,253,739.00	9,326,400,485.90
2042	11,031,983.00	1,467,253,739.00	7,859,146,746.90
2043	11,031,983.00	1,467,253,739.00	6,391,893,007.90
2044	11,031,983.00	1,467,253,739.00	4,924,639,268.90
2045	11,031,983.00	1,467,253,739.00	3,457,385,529.90
2046	25,995,379.92	3,457,385,529.90	-
TOTAL	367,751,243.92	48,910,915,441.90	



AKT RAKORDIM

ANEKS

AKT RAKORDIMI PER QELIME TE SHTOJCËS NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES NR. 208 REP., NR. 97 KOL., DATË 06.04.2018, PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA KESH SH.A.-OSHEE SH.A.

Emërtimi	Monedha	Gjendje 22.04.2021		
		Valute	Kurs Këmbimi BSH	ALL
Prodhimi energjisë + Mbulim Humbje (OSHEE)	LEK			32,195,092,242.00
OSHEE - Permbartim pa regjistruar				-
OSHEE - Mbulim Humbje	EUR	-	123.10	-
Diference mare permbartimi per fatura - pa regjistruar	LEK			- 2,858,932.00
VKM 482 dt.05.06.2015				- 222,670,734.56
OSHEE - Penalitete	LEK			14,668,407,404.00
OSHEE - Penalitete	LEK			95,651,066.46
OSHEE - Penalitete	EUR	-	123.10	-
OSHEE - Shitje nga importi	EUR	-	123.10	-
OSHEE - penalitete per vonesa ne pages	LEK			2,143,029,549.00
1. Totali për detyrimet e energjisë	LEK			48,876,650,594.90
Detyrim për transferim aseti	LEK			17,400,414.00
OSHEE - Shitje Materialelesh	LEK			16,864,433.00
2. Totali detyrimit asete				34,264,847.00
3. Totali detyrimit KESH (1+2)				48,910,915,441.90



Nr. 2585...Prot

Tiranë, më 15/04/2021

Nr. 3881...Prot

Tiranë, më 15/04/2021

MARRËVESHJE PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA

- **Operatori i Sistemit të Transmetimit**, shoqëri aksionere, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, datë 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Tiranë, me adresë: Autotrada Tiranë- Durrës, Km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42101801N, përfaqësuar në mënyrë të rregullt nga **Z. Skerdi Drenova**, përfaqësues ligjor i kompanisë, me dokument indentifikimi (Letërnjoftimi) Nr. 031722371, Nr. Personal 1700925135 lëshuar më datë 20.04.2012 (më poshtë referuar si “**OST**” ose “**Kreditori**”)

dhe

- **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sha**, (regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 38587, datë 19/06/2007, me seli në Shqipëri, me adresë : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, pajisur me NIPT K72410014H, përfaqësuar në mënyrë të rregullt nga **Z. Adrian Çela**, përfaqësues ligjor i kompanisë, me dokument indentifikimi (Letërnjoftimi) Nr. 033853838, Nr. Personal G 70226165H lëshuar me datë 26.01.2019 (më poshtë referuar si “**OSHEE**” ose “**Debitori**”);

Secila nga palët e mësipërme referohet në vijim, veçmas si “Pala” dhe së bashku si “Palët”

Baza ligjore:

- Ligji nr.7850, date 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar;
- Ligji nr.170/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike”;
- Ligji Nr. 48/2014 “Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 253, date 24.4.2019 “Per miratimin e planit te konsolidimit financiar te sektorit publik elektroenergjitik;
- Vendim i Bordit te ERE nr. 111, date 01.07.2016 “Mbi lenien ne fuqi te vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, date 26.12.2014 te Bordit te Komisionereve te ERE-s per periudhen 1 Korrik 2016-31 Dhjetor 2016”;
- Vendim i Bordit te ERE nr. 190, date 22.12.2016 “Mbi lenien ne fuqi te vendimeve nr. 139, nr. 145, 146, 147, 148, date 26.12.2016, Vendimit nr. 128, date 29.07.2016 te Bordit te ERE-s deri ne 31.03.2017”;
- Vendim nr. 266, date 21.12.2018 “Mbi percaktimin e tarifes se sherbimit te transmetimit te energjise elektrike per vitin 2019”.
- Urdheri i Përbashkët i MFE dhe MIE nr 304 datë 17.12.2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”

Në vijim sa me sipër, Palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1. Qëllimi i Marrëveshjes

Kreditori dhe Debitori nënshkruajnë këtë Marrëveshje me qëllim shlyerjen e plotë, të pakushtëzuar dhe përfundimtare të të gjithë detyrimit të prapambetur nga Debitori tek Kreditori në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Detyrimi i prapambetur, sipas kësaj Marrëveshjeje, është detyrimi deri në vlerën që dy palët Debitori dhe Kreditori kanë dakordësuar deri më datën **31 Dhjetor 2020**, në vlerën **9,687,768,309 Lekë**.

Nëse kjo vlerë detyrimi do të ndryshojë në të ardhmen me dakortesi midis palëve, Vlera e Ndryshuar do të shtohet apo pakësohet Vlerës Totale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2. Pagesa e detyrimit

- 2.1 Palët bien dakord që Debitori të paguajë detyrimin e prapambetur në pagesa mujore, duke filluar nga data **01.07.2021** e derisa ky detyrim të shlyhet plotësisht.
- 2.2 Detyrimi i prapambetur do të shlyhet sipas një pagese të barabartë me **6.5 % të shumës totale të faturës korrente** të shërbimit të trasmetimit të energjisë elektrike dhe faturës së disbalancave të lëshuara nga Kreditori për FSHU dhe FTL, por **jo më pak se 360 milionë lekë në vit** deri në shlyerjen e plotë të detyrimit.
- 2.3 Çdo pagesë mujore, do të jetë e ndryshueshme në varësi të vlerës së shumës totale të faturave mujore të lëshuar nga Kreditori, të parashikuara në pikën 2.2 të këtij neni.
- 2.3.1 Kjo pagesë e ndryshueshme do të përcaktohet si përqindje mbi shumën totale të faturave mujore të parashikuara në pikën 2.2 të këtij neni.
- 2.3.2 Vlera e përqindjes për t'u paguar si shtesë mbi faturat mujore të parashikuara në pikën 2.2 të këtij neni, do të shlyhet brenda afateve të parashikuara për shlyerjen e faturës së shërbimit të trasmetimit të energjisë elektrike të referuar në pikën 2.2 të këtij neni.
- 2.3.3 Vlera totale e paguar në një vit nuk duhet të jetë më e vogël se **360 milionë lekë në vit**.
- 2.3.4 Debitori, në varësi të situatës financiare, mund të kryejë likuidime mbi përqindjen e caktuar në pikën 2.2 deri në shlyerjen e plotë të detyrimit.
- 2.3.5 Nëse vlera e paguar si % mbi faturat mujore është më e vogël se **360 milionë lekë në vit**, diferenca paguhet në muajin e fundit të vitit.

Neni 3. Detyrimet e Debitorit

- 3.1 Debitori premtan dhe merr përsipër të kryejë pagesën e vlerën e rënë dakord dhe afatet e përcaktuara në këtë marrëveshje.
- 3.2 Debitori nuk do të ngrejë asnjë pretendim, të drejtë, kërkesë ose ankesë lidhur me ekzistencën e detyrimit dhe cilësinë e tij si Debitor ndaj Kreditorit.

Neni 4. Deklarimi dhe Garancitë e Debitorit

- 4.1 Debitori, me anë të kësaj Marrëveshjeje garanton, njeh dhe pranon:
- që të gjitha shumat e detyrimit ndaj Kreditorit janë të sakta, dhe shprehimisht pa kushte dhe pranon cilësinë e saj si Debitore ndaj kreditorit për shumën e detyrimit dhe se nuk ka pretendime, të drejta, kërkesa, ankesa dhe/ose ndonje shkak tjetër të pretendimit të çfaredo natyre, që rrjedhin nga/ose në lidhje me detyrimin ose cilësinë e tij si Debitor;

- Debitori do të kryejë pagesat brenda afateve dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.
- Për çdo vonesë në kryerjen e pagesave, tej afateve të përcaktuara në këtë marrëveshje, vlerës së njoftuar të pagesës do ti shtohet automatikisht interes për vonesën në përputhje me Ligjin 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare” i ndryshuar..
- Debitori është shoqëri aksionare (sh.a.) e inkuorporuar sipas rregullave dhe në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe ka dhe do të ketë në çdo kohë autorizimet dhe kompetencat e nevojshme ligjore për të lidhur dhe marrë përsipër detyrimet e saj sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshjeje;
- se personi/at që nënshkruajnë këtë Marrëveshje ka/kanë kapacitet dhe kompetenca të plota për të përfaqësuar Debitorin;
- cilësia e Debitorit si palë e kësaj Marrëveshjeje është në përputhje me ligjin shqiptar;
- asnjë pretendim apo procedure ne proces ose kerccenim perpara ndonje gjykate ose kolegji arbitrazhi, ne Republikën e Shqiperise ose jashte vendit, nuk do te ndikojte materialisht ne permbushjen e detyrimeve te debitorit sipas kesaj Marreveshjeje.
- Debitori nuk rezulton te jete i paaftë të paguajë (ka aftësi paguese) ose t'i jetë nënshtruar procedurave të mbylljes likuidimit, falimentimit ose procedurave të ngjashme dhe nuk mund të parashikohet ne menyre të arsyeshme që Debitori t'i nënshtrohet procedurave të mësipërme;
- Debitori më tej pohon, garaton dhe merr përsipër ndaj Kreditorit që përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme do të jenë të vërteta dhe të sakta gjatë gjithë vazhdimit të kësaj Marrëveshjeje, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë herë pas here.

Neni 5 Data e Hyrjes në fuqi dhe Përfundimi i Marrëveshjes

5.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi sapo të jetë nënshkruar nga të gjitha Palët (“Data e Hyrjes në Fuqi”) dhe do të përfundojë pasi të jetë paguar plotësisht i gjithë detyrimi i përcaktuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

5.2 Kjo Marrëveshje mund të ndërpritet automatikisht nga Kreditori në rast se ndodh një nga rastet shkakësore të mëposhtme (**Rast Shkakësor mospërmbushje**):

- Asnjë ose ndonjë nga detyrimet e Debitorit siç tregohet ne nenet 2,3 dhe 4 nuk plotësohen nga Debitori;
- Çdo apo ndonje deklarate dhe/ose perfaqesim dhe garanci e bere nga Debitori sipas kesaj Marrëveshjeje ekzistojnë në Datën Efektive dhe më pas bëhen, të pavërteta, të pasakta ose çorientuese; dhe/ose

- Çdo apo ndonjë pjesë e kësaj Marrëveshje shpallet nga nje gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, si i pavlefshëm dhe/ose i pazbatueshëm për çfarëdo arsye të Debitorit.

Neni 6. Efekti i Rasteve Shkakësore

- 6.1 Në rast të verifikimit të ndonjërit prej rasteve Shkakësore, Kreditori mund të ekzekutojë menjëherë këtë Marrëveshje dhe të filloje procedurat e përmbarimit ndaj Debitorit për ekzekutimin e detyrimit;
- 6.2 Në rast të verifikimit të ndonjërit prej rasteve shkakësore, Debitori i detyrohet Kreditorit për çfarëdo lloj dëmi dhe shpenzimi që i ka ardhur si pasojë e ndodhjes së Rastit Shkakësor.

Neni 7. Delegimi (Zëvendësimi)

7.1 Kreditori mund të delegojë me autorizimin, çdo të drejtë ose të drejtë të ushtrueshme nga ana e kreditorit e lindur nga kjo Marrëveshje, tek një palë e tretë. Një delegim (zëvendësim) i tillë mund të bëhet me terma dhe kushte të tilla (duke përfshirë edhe të drejtën për zëvendësim debitori) ashtu si Kreditori e konsideron të përshtatshme.

Neni 8. Shpenzimet

Debitori do t'i paguajë Kreditorit sipas kërkesës, të gjitha kostot e dokumentuara, tarifat dhe shpenzimet (duke përfshirë, pa ndonjë kufizim, tarifat ligjore) që kreditorit do t'i krijohen, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe mbledhjen e detyrimit.

Neni 9. Mjetet Juridike Jo Ekskluzive

Të gjitha të drejtat, kompetencat dhe mjetet juridike qe Kreditori i gëzon sipas kësaj Marrëveshjeje mund të ushtrohen secila më vete ose të gjitha së bashku do të cilësohen si plotësuese dhe jo zëvendësuese të ndonjë te drejte tjetër të tashme ose të ardhme të Kreditorit dhe të ndonjë/cdo të drejte, kompetence dhe mjeti juridik qe Kreditori gëzon, sido që ato të jenë krijuar.

Neni 10. Dëmshpërblimi, Tatimet, Kostot dhe Shpenzimet

10.1 Të gjitha detyrimet, taksat dhe pagesat e tjera publike, duke perfshirë, por pa u kufizuar në, tarifat e regjistrimit gjyqësor dhe tarifat noteriale, shpenzimet, detyrimet ne lidhje me përgatitjen, negocimin, përfundimin, dorëzimin, regjistrimin, plotësimin, ekzekutimin, përsosjen, ndryshimin,

heqjen dorë, pëlqimin, shkarkimin, lirim, ruajtjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do te barten nga Debitori.

10.2 Debitori, sipas kërkesës, do të rimbursojë Kreditorin për të gjithë taksat, kostot, shpenzimet dhe tarifatat (përfshirë tarifatat ligjore dhe noteriale) të bëra nga Kreditori në lidhje me:

(ii) çdo dështim nga Debitori për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 11. Komunikimi

11.1 Forma e njoftimeve

Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera nën ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të jepen me shkrim dhe mund të bëhet me e-mail dhe / ose faks. Çdo njoftim i tillë do të konsiderohet i dhënë kur e-mail ose faksimili të merret nga marrësi, me kusht që një njoftim i marrë në një ditë Jo pune të konsiderohet të jepet në Ditën e ardhshme të Punës. Çdo njoftim i një Rasti Shkakësor duhet, përveç kësaj, të jepet me anë të postës së certifikuar.

11.2 Komunikimi do të trajtohet si vijon:

a) Për Kreditorin:

Në vëmendjen e: _____

Adresë: _____

e-mail: _____

Fax:

(b) Për Debitorin:

Në vëmendjen e: _____

Adresë: Blv. _____

e-mail: _____

Fax:

Neni 12. Të ndryshme

12.1 Ndryshimet e Marrëveshjes

Asnjë ndryshim ose heqje dorë nga ndonjë kusht i kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë pëlqim ose miratim i dhënë nga Kreditori nuk do të jetë efektiv nëse nuk është bërë me pëlqimin me shkrim të Kreditorit dhe Debitorit. Kreditori mund të japë zgjatje të kohës dhe privilegje të tjera, të bëjë kompromis, të

akordojë lëshime, të ulë detyrimin apo të japë cdo lehtësim tjetër që e çmon të arsyeshme, pa i paragjykuar detyrimet dhe të drejtat e Debitorit dhe të drejtat e Kreditorit që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose Ligjit Shqiptar.

12.2 *Kalimi i Marrëveshjes*

Debitori nuk do të transferojë ose caktojë teresisht ose pjesërisht, asnjë nga të drejtat dhe detyrimet e Debitorit të ardhura sipas kësaj Marrëveshjeje pa pëlqim paraprak me shkrim të Kreditorit. Kreditori mund ti transferojë të drejtat e tij/ saj sipas kësaj Marrëveshjeje çdo pale tjetër pa pëlqim paraprak të Debitorit.

12.3 *Mjetet juridike kumulative*

(i) Të drejtat, kompetencat dhe mjetet juridike të Kreditorit sipas kësaj Marrëveshjeje janë kumulative dhe nuk janë dhe as nuk duhet të interpretohen si, heqje dorë nga ndonjë e drejtë, kompetencë ose mjet juridik i parashikuar me ligj ose ndryshe i cili mund të ushtrohen herë pas here sa herë e konsideron të arsyeshme Kreditori.

(ii) Asnjë vonesë ose mosveprim nga ana e Kreditorit në ushtrimin e çfarëdo të drejte ose mjeti juridik sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të dëmtojë atë të drejtë ose mjet juridik, ose vlerësohet si heqje dorë prej tij dhe asnjë ushtrim i vetëm, i pjesshëm ose jo i plotë i çdo të drejte ose mjeti të tillë nuk përjashton ushtrimin e një të drejte tjetër ose ushtrimin e mëtejshëm të të drejtave që rrjedhin sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë të drejte ose mjeti ligjor tjetër.

12.4 *Pavlefshmëria e pjesshme*

Nëse në çdo kohë ndonjë ose disa prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje janë ose bëhen të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme në çdo aspekt sipas ndonjë ligji të ndonjë juridiksioni, atëhere ligjshmëria, vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Marrëveshjeje, si dhe ligjshmëria, vlefshmëria apo zbatueshmëria e këtyre dispozitave sipas ligjit të çdo juridiksioni tjetër nuk do të ndryshohen, zhvlerësohen apo dëmtohen. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, por do të ishte e vlefshme nëse një pjesë e dispozitës do të fshihej, dispozita në fjalë do të zbatohet me një modifikim të tillë që mund të jetë i nevojshëm për ta bërë këtë dispozitë të vlefshme.

Neni 13. Ligji I zbatueshëm dhe juridiksioni

13.1 Kjo marrëveshje hartohet dhe interpretohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe palët, nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, bien dakort të jenë nën juridiksionin e gjykatave shqiptare.

13.2 *Heqja dorë nga imuniteti Sovran*

Debitori pohon dhe garanton se kjo Marrvëshje dhe të drejtat dhe detyrimet e përmbajtura këtu janë akte kontraktore dhe jo akte publike ose qeveritare dhe se Debitori nuk ka të drejtë të kërkojë imunitet nga procedurat ligjore në lidhje me vetveten ose cilëndo nga pasuritë e tij për shkak të sovranitetit ose sipas çdo ligji ose në ndonjë juridiksion ku mund të ngrihet një veprim për zbatimin e ndonjë prej detyrimeve që rrjedhin nga ose që lidhen me këtë Marrvëshje. Në masën që Debitori ose ndonjë nga pasuritë e tij ka, ose në të ardhmen mund të fitojë, ndonjë të drejtë imuniteti për përjashtim, procedim ligjor, përjashtim nga e drejta për gjykim, përjashtime të tjera ose ekzekutimi I vendimit gjyqësor për shkak të sovranitetit ose shkaqe të tjera të ngjashme, Debitori heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga këto të drejta për imunitet në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga ose që kanë të bëjnë me këtë Marrvëshje.

13.3 Privilegjet dhe imunitetet e Kreditorit

Asnjë në këtë Marrvëshje nuk do të interpretohet si heqje dorë, mohim ose modifikim tjetër I çdo imuniteti, privilegji ose përjashtimi të Kreditorit. Asnjë në këtë Marrvëshje nuk do të interpretohet si heqje dorë, mohim ose modifikim tjetër I çdo imuniteti, privilegji ose përjashtimi të Kreditorit.

Neni 14. Data e Hyrjes në Fuqi

Kjo marrvëshje hyn në fuqi në datën që është pranuar dhe nënshkruar nga palët..

Neni 15. Palët

Kjo Marrvëshje hartohet në 4 (katër) kopje secila me vlerë të njëjtë, në gjuhën Shqipe NË VIJIM TË SA MËSIPËR, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrvëshje të nënshkruhet në emrat e tyre përkatës, në datën dhe vitin e cilësuar në fillimin të aktit.

PALËT QE DO NËNSHKRUAJNË:

PËR LLOGARI TË OST SH.A.

ADMINISTRATORI I OST SH.A.

SKERDI DRENOVA



PËR LLOGARI TË OSHEE SH.A.

ADMINISTRATORI I OSHEE SH.A.

ADRIAN ÇELA



Aneksi 1

Vlera totale e marrëveshjes

Detyrime të OSHEE ndaj OST deri më 31.12.2020	Vlera në Lekë
Transmetim i energjisë elektrike	7,763,619,168.78
Disbalanca të energjisë në Lekë	2,728,749,897.11
Disbalanca të energjisë në Euro	58,539,108.89
Disbalanca të energjiëse Prill 2012	24,518,730.00
Kolaudim mates	12,000.00
Pagesë pune për shërbimet e DTL Tiranë	3,144,361.00
Matësa elektrike me NJOF	1,162,720.50
Totali	10,579,745,986.28
Detyrime të OST ndaj OSHEE deri më 31.12.2020	Vlera në Lekë
Disbalanca të energjisë në Lekë	891,977,677.00
Totali	891,977,677.00
Neto	9,687,768,309